**VENDIM**
**Nr. 75/2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 5/2015 "PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015 "Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Në pikën I, numri "4", fjala "anëtare", përbri emrit Vasilika Hysi, zëvendësohet me fjalën "sekretar".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 9.7.2015